



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 482 prot.

Tiranë, më 18. 03 . 2022

V E N D I M

Nr. 57, datë 18 . 03 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 236 Regj., datë 17.12.2021, të shtetases S. L¹, kundër Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej saj gjatë pjesëmarrjes në operan “La Boheme”, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP ose Teatri), duke parashtruar si më poshtë vijon:

“Më datë 15.12.2021, kam blerë biletën për të ndjekur operan “La Boheme” në TKOBAP. Pasi parashtrova se jam person me aftësi të kufizuar (PAK) m’u komunikua që bileta ime ishte në radhën E, karrigia nr.32, dhe se çmimi i biletës ishte 1000 lekë, tarifë e cila ishte e njëjtë për të

¹ Si përfaqësuese e Fondacionit “Së Bashku” (në pozicionin e drejtorit ekzekutiv të tij), dhe si individ, referuar Librezës me nr. 00078, datë 11.02.2019, si dhe Vërtetimit mjeko-ligjor të lëshuar nga KMCA/SHërbimi Social Shtetëror.

² Referuar dokumentacionit mjekësor, ankuesja gëzon statusin e tetraplegjikut.

³ Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

gjithë, megjithëse unë si person me aftësi të kufizuar duhet ta përfitoja me çmim të përgjysmuar. Pasi u paraqita në ambientet e TKOBAP, stafi nuk kishte informacion se ku ishin vendet e dedikuara për PAK dhe vendi që më ishte caktuar në biletë ishte i paaksesueshëm nga ana ime sepse ishin të pranishme shkallët. Pasi kontaktova me stafin, i sqarova që duhet të qëndroj në një hapësirë të sheshpushimit afër me karrigen e një radhe tjetër. Gjithashtu, në lidhje me kërkesën time për tarifën e biletës, m'u komunikua se nuk kanë një udhëzim të veçantë të miratuar për PAK”.

Lidhur me sa më lart, ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar, *së pari, si individ*, nga ana e TKOBAP, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke iu mohuar dy të drejta që duhej t'i njiheshin e siguroheshin nga ana e subjektit TKOBAP (*Teatri*), siç janë: përfitimi i biletës për të ndjekur shfaqjen me çmim të përgjysmuar, si dhe qëndrimi në vendet e dedikuara për PAK, në ambientet e sallës ku jepen shfaqjet e Teatrit, dhe *së dyti, në tagrin e përfaqësueses së Fondacionit “Së Bashku”*, ka pretenduar se diskriminohet e gjithë kategoria e PAK, me të njëjtën aftësi të kufizuar si ajo, përmes mohimit të aksesimit të vendeve të dedikuara për PAK.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit ndaj saj nga ana e TKOBAP, për shkak të aftësisë së kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar (*përfshirë edhe vetë ankuesen, shtetasen S. L*) lidhur me: çmimin e biletave të shitura për shfaqjen “La Boheme”, të datës 15.12.2021 dhe mungesën e vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të TKOBAP.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtëpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e TKOBAP.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes

të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”.

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:
““Palë” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;*
- b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.*

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;*
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;*
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”*

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se subjekti ankues legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, e cila përveç interesit të drejtëpërdrejtë të shtetases S. L, prek edhe gjithë grupin e personave me AK me status tetraplegjiku, në kushte të njëjta apo të ngjashme me të.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Fondacioni “Së bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, edhe në kuadër të përfaqësimit të interesit të ankueses si individ, por edhe në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, me status tetraplegjiku, në kushte të njëjta apo të ngjashme me S. L.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. “Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup

tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 1726/1 prot., datë 28.12.2021 nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e ankueses.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, TKOBAP me anë të shkresës nr. 10 prot., datë 10.01.2022, ka informuar Komisionerin, si më poshtë vijon:

“Sa i përket pretendimit të parë lidhur me çmimin e biletës prej 1000 lekësh, TKOBAP, i kërkon ndjesë znj. L për shqetësimin e krijuar, pasi punonjësja e Teatrit është e re në detyrë dhe nuk ka e kuptuar drejt kërkesën e znj. L. Lidhur me shqetësimin e krijuar, Insitucioni ofron mundësinë e znj. L të marrë rimbursimin e biletës si dhe të ndjekë një shfaqje të kalendarit tonë artistik në vijim pa pagesë. Gjithashtu ju sigurojmë se punonjësja në detyrë ka shoqëruar dhe akomoduar në sheshpushimin e sallës, aty ku ishte i mundur qëndrimi i znj. L, me shumë korrektesë dhe mirësjellje.

Sa i përket pretendimit të dytë, lidhur me mungesën e informacionit për vendin e dedikuar për personat me aftësi të kufizuar, ju sqarojmë se, sipas planimetrisë aktuale të Teatrit, realisht nuk ka vende të dedikuara për PAK, por pavarësisht kësaj, jemi munduar të përshtatim hapësirën në rreshtin me korridorin më të gjerë dhe me akses të drejtpërdrejtë nga njëra prej dyerve hyrëse. Nëse në të ardhmen me vendimmarrje të përbashkët me Ministrinë e Kulturës mund të vendoset të heqim disa karrige për të mundësuar qëndrimin e PAK, mund të bëhet i mundur dhe akomodimi i tyre. Gjithashtu, ju informojmë se ka hapësira edhe krahas rreshtave të tjerë por për shkak të shkallëve e bën të vështirë akomodimin e spektatorëve me AK”.

2. Në vijim të përgjigjes së TKOBAP, me shkresën me nr. 82/1 prot., datë 31.01.2022, Komisioneri ka informuar Teatrin se vlerëson masat e ndërmarra në kuadër të pretendimit të parë të ankueses, si dhe lidhur me pretendimin e dytë, ka kërkuar që bazuar në kapacitetin e vendeve të Teatrit dhe vendeve që duhet të ishin të dedikuara personave me AK, të informojë Komisionerin lidhur me marrjen e masave efektive dhe konkrete për zgjidhjen e kësaj problematike, në përmbushje të specifikimeve të bëra në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.*
3. Me shkresën me nr. 1012 prot., datë 18.02.2022, TKOBAP, ka informuar Komisionerin se, situata mbetet e njëjta me atë të bërë të njohur nëpërmjet shkresës me nr. 82/1 prot., datë 31.01.2022 të tij, duke cituar ndër të tjera se:

“Në zbatim të protokollit të masave kundër Covid-19 të dala për zbatim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale momentalisht salla përdoret deri në 30% të kapacitetit të saj, duke përshtatur dhe akomoduar PAK, pa penguar protokollin dhe lëvizjet e spektatorëve. Për të përmirësuar shërbimin për PAK, si dhe mundësinë e akomodimit me 16 vende të dedikuara për PAK, në i bëjmë kërkesë Ministrisë së Kulturës, për të çuar një hap më tej çështjen e aksesibilitetit me vende të dedikuara për PAK, si dhe për një vlerësim dhe në dhënien e rekomandimeve adekuate për të ndihmuar stafin tonë, të shtojë dhe përmirësojë aftësinë e shërbimit dhe ndërveprimin me spektatorët të cilët mund të kenë nevojë për asistencë shtesë. Bazuar tek projekti i investimit nga Ministria e Kulturës në Institucion, janë vendosur rampat, tualetet për PAK, por nuk janë bërë parashikimet konkrete për vende të dedikuara PAK”.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar dhe vlerësuar veprimet e Teatrit kundrejt subjektit ankues, në raport me të drejtat e tij ligjore.

A.1 Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm sa i përket çmimit të biletës për PAK dhe subjektin ankues.

Bazuar në deklaratimet e të dyja palëve, *(si subjekti ankues, ashtu dhe palës kundrejt të cilës është pretenduar trajtimi i pafavorshëm dhe diskriminues)*, si dhe rrethanat e faktet, rezulton e vërtetë, e pranuar dhe e provuar, si më poshtë citohet:

- Çmimi i biletës për shfaqjen “La Boheme”, vënë në skenë me datë në 15.12.2021 në TKOBAP, për të gjithë personat, përfshirë ato me AK, me status tetraplegjiku, sikurse ishte rasti i ankueses, ishte 1000 lekë.
- Nga publikimet e bëra në faqen zyrtare të Teatrit, deri me datë 17.12.2021, lidhur me tarifatat e miratuara për të parë shfaqjet vërehet se nuk ka një tarifë të ndryshme, më të favorshme për personat me aftësi të kufizuara.
- TKOBAP, i ka kërkuar ndjesë znj. L për shqetësimin e krijuar, me argumentimin se punonjësja e Teatrit ishte e re në detyrë dhe nuk ka e kuptuar drejt kërkesën e znj. L.
- Lidhur me shqetësimin e krijuar, Insititucioni i ka ofruar mundësinë ankueses të marrë rimbursimin e biletës si dhe të ndjekë një shfaqje të kalendarit artistik të Teatrit, në vijim pa pagesë.
- Komisioneri konstaton se, nga ana e Teatrit janë marrë masa të menjëhershme pas shkresës së dërguar me datë 28.12.2021 lidhur me problematikën e krijuar për çmimet e biletave të shfaqjeve për personat me aftësi të kufizuara, si përsa i takon rastit individual të ankueses, ashtu edhe disa kategori përfituese të PAK. Kështu;
- Pas datës 28.12.2021, në faqen zyrtare të Teatrit, tek rubrika e çmimeve të biletave⁴ është publikuar shtojca nr. 2 me titull “*Reduktimet e biletave bazuar në kategoritë sociale*”, si më poshtë pasqyrohet:

⁴ https://tkob.gov.al/?page_id=21

Kategoria	Masa e reduktimit në %, në raport me tarifat bazë të biletave
Pensionistët	25%
Invalidët e punës	50%
Paraplegjik/tetraplegjik	50%
Jetimët	50%
Studentët	50%
Fëmijë (mosha 6-18 vjeç)	50%
Të verbërit	100% (hyrja falas)

Në nenin 12, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50% të çmimit të biletës”.

Në këtë kuadër, lidhur me sa më lart, Komisioneri vlerëson se hapat e ndërmarrë nga ana e TKOBAP, lidhur me problematikën e hasur nga ankuesja, por dhe gjithë kategoria e PAK, konkretisht me statusin e tetraplegjikut, përsa i takon reduktimit të çmimit të biletave, bazuar në aktet ligjore në fuqi, kanë qenë konkrete dhe të menjëhershme, si për rastin në fjalë të subjektit ankues, po ashtu për gjithë kategorinë e PAK, personave me status tetraplegjiku sikurse ankuesja.

Komisioneri, vëren se, qëllimi për të cilin dhe është iniciuar procedura hetimore, lidhur me pretendimin e parë të subjektit ankues, atë të çmimit të biletës së shfaqjes në Teatër, për PAK me status tetraplegjiku, është përmbushur gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes pranë KMD-së.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Për sa më sipër, bazuar në masat e hapat e ndërmarrë nga ana e Teatrit, lidhur me publikimin në faqen zyrtare të masës së reduktimit të biletave të shfaqjeve në raport me tarifat bazë të biletave, bazuar në kategoritë sociale që e përfitojnë atë (përfshirë dhe kategorinë ku bën pjesë ankuesja) dhe konkretizimin e kësaj mase për PAK, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e subjektit ankues, lidhur me

pretendimin e parë të saj, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim⁵.

Por, pavarësisht sa më sipër KMD gjykon se, në kuadër të zbatimit të dispozitave ligjore për kategori të caktuara personash që posedojnë aftësi të kufizuara specifike, lidhur me reduktimin e çmimit të biletave, TKOBAP, duhet të ndër marrë masa pozitive, lidhur me mundësinë për përfitimin nga reduktimi i çmimit të biletave, për të gjithë kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara⁶”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: *“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërvëprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”.*

Përcaktimin nëse një person është me aftësi të kufizuara, e bën Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP) ose Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK), bazuar pikërisht në dëmtimet fizike, intelektuale apo shqisore të tyre.

Në këtë kontekst, në kategorinë e PAK, hyjnë ato persona që janë diagnostikuar dhe vlerësuar si të tillë nga KMCAP ose KSHVAK përkatëse.

Përjashtimi i kategorive të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, përveç atyre kategorive që citohen nominalisht në faqen zyrtare të **web-it** të TKOBAP, nga e drejta e përfitimit të mundësisë për reduktim të çmimit të biletës; i privon ata nga e drejta për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë me kategoritë e PAK të cilët rezultojnë përfitues, që janë: invalidët e punës, të verbërit dhe para e tatraplegjikët.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se, ka një diferencë në trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, lidhur me përfitimin e reduktimit të çmimit të biletës, e cila vjen pikërisht për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar.

Ky fakt, bie ndesh edhe me parimin e mosdiskriminimit e gjithëpërfshirjes, në ligjin nr. 93/2014 *“Për përshatjen dhe Aksesueshmërinë”*, të ndryshuar, ku termi “aksesueshmëri” përcakton mënjanimin e pengesave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe pengesat institucionale: ato në legjislacion dhe në politikat e ndryshme hartuar në ndihmesë të personave me AK.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me

⁵ Neni 33, pika 9 e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.*

⁶ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁷⁷.

Në nenin 32, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: "*Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*".

Bazuar në sa më lart, Komisioneri rekomandon TKOBAP, në kuadër të marrjes së masave pozitive për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, të përfitojnë reduktimin e çmimit të biletës së shfaqjeve në Teatër, të gjitha kategoritë e PAK.

A.2 Lidhur me pretendimin e dytë të subjektit ankues, se është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e TKOBAP, përsa i takon aksesueshmërisë në vendet e dedikuara për PAK, në sallën e shfaqjeve të Teatrit.

Bazuar në analizimin e fakteve, kronologjinë e ngjarjeve dhe legjislacionin përkatës, rezulton se:

TKOBAP me datë 15.12.2021 ka vënë në skenë operan "La Boheme". Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e Teatrit, pasi në sallën e shfaqjeve ku ajo ka ndjekur operan, nuk ka patur vende të dedikuara për të, si person me AK, me status tetraplegjiku, në përmbushje të specifikimeve të bëra në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 "*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar*".

Ky pretendim i ankueses rezulton të jetë i vërtetë, pasi një fakt i tillë është pranuar si i mirëqenë nga ana e TKOBAP, madje dhe ka shprehur vullnetin se: "*Nëse në të ardhmen me vendimmarrje të përbashkët me Ministrinë e Kulturës mund të vendoset të heqim disa karrige për të mundësuar qëndrimin e personave me aftësi të kufizuar, mund të bëhet e mundur dhe akomodimi i tyre*".

Në këtë kontekst, bazuar në këto rrethana fakti, Komisioneri ka analizuar veprimet e mosveprimet e Teatrit, përsa i takon përmbushjes së detyrimit ligjor për aksesueshmërinë e PAK, me status para dhe tetraplegjiku, në vendet e dedikuara për ta në sallën e shfaqjeve të tij.

⁷⁷ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Kështu, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në nenin 5, pika 1 dhe pika 2, shkronja ç), të tij ka përcaktuar se:

“1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare. 2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;”.

Këshilli i Ministrave, në zbatim të sa më sipër, ka miratuar vendimin me nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, lidhur me detyrimin e institucioneve për zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Fusha e aplikimit të këtij vendimi, shtrihet në:

- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t’i nënshtrohen rikonstruksionit;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

Neni 1, i kësaj VKM-je ka përcaktuar se:

“Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”. Në kuptim të kësaj VKM-je, barrierat arkitektonike janë:

- a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuara të përhershme ose të përkohshme;*
- b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse;*
- c) mungesat e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut për këdo dhe në veçanti për personat me shikim apo dëgjim të kufizuara”.*

Nenet 18⁸, 19⁹ dhe 20¹⁰, të VKM-së, përcaktojnë se:

“18. Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore dhe të plotësojë kushtet në vijim:

- të jetë i vendosur horizontalisht deri në 90 cm lartësi dhe vertikalisht deri në 180 cm lartësi nga kuota e dyshemesë;
- të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesës;
- të përmbajë informacion në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij relievore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- të tregohet drejtimi për ta arritur me shenjën figura 1.2 dhe 1.3

19. Pulti për PAK-në përdorues të karrigeve me rrota duhet të jetë:

- i vendosur afër hyrjes në hapësira dhe/ose në hapësirën ku ofrohen shërbimet;
- i vendosur në lartësi prej 80 cm, me lartësi shikimi të paktën 70 cm;
- në formë konsoli me thellësi afrimi të paktën 50 cm;
- me arritshmëri të paktën 120 cm. Shenja treguese e arritshmërisë sipas fig. 1.23 të shtojcës A. Pult i përshtatur për persona që nuk dëgjojnë dhe me dëgjim të dobësuar, persona që nuk shikojnë dhe me shikim të dobësuar, nënkuptohet pulti me lartësi të zakonshme, i cili duhet të plotësojë këto kushte, të ketë:

- elementë ndihmës komunikues;
- vijat relievore drejtuese në drejtim të lëvizjes prej derës hyrëse në ndërtesë deri te pulti;
- shenja arritshmërisë sipas fig. 1.2, 1.3, 1.4, 1.6 dhe 1.21 të Shtojcës A.

Kur në sallë ndodhen tri ose më shumë pulte për të njëjtë lloji shërbimi, njëri nga të tre duhet të plotësojë kushtet e përshtatjes për PAK-në përdoruese të karrocave, një për personat që nuk dëgjojnë ose me dëgjim të dobësuar, dhe për persona që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar. 2. Tabelat e lajmërimeve duhet të vendoset në lartësi prej 120 deri 160 cm. Ato tregohen me shenjë arritshmërisë sipas fig. 1.24 të shtojcës A”.

.....

20. Sporteli për PAK, shfrytëzues të karrocave duhet të plotësojë këto kushte, të ketë:

- sipërfaqen e sipërme të realizuar në lartësi deri në 85 cm, me lartësi shikimi jo më pak se 70 cm, i realizuar në forme konsoli me thellësi e afrimi jo më pak se 50cm;
- shenja e arritshmërisë sipas fig. 1.23 të shtojcës A të kësaj rregulloreje”.

Në nenin 15¹¹, Kreu III¹² të kësaj VKM-je, parashikohet si më poshtë citohet:
“Vendet në sallat e shfaqjeve duhet të kenë dimensione të bazës minimumi 90 x 140cm dhe të tregohen me shenjë figura 1.20 shtojca A, përshtatja tregohet me figurën 28 shtojca B.

⁸ “Plani orientues për lëvizjen në ndërtesa”

⁹ “Pulti”.

¹⁰ “Sporteli”.

¹¹ “Vendet në sallat e shfaqjeve”

¹² “Zbatimi i rregullave”

Numri i nevojshëm i vendeve të përshtatura në sallat e shfaqjeve, përcaktohet në bazë të numrit total të vendeve ulur dhe:

- për 100 deri 300 vende ulur minimumi dy prej tyre duhet të jenë të përshtatura;
- për 301 deri 1000 vende ulur, minimumi 2% e tyre duhet të jenë të përshtatura;
- për më shumë se 1001 vende ulur, minimumi 1% e tyre duhet të jenë të përshtatura”.

Në interpretim të sa më sipër, referuar kapacitetit të vendeve të TKOBAP-së (prej 800 vendesh), si dhe në zbatim të VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, ku përcaktohet se:

“Numri i nevojshëm i vendeve të përshtatura në sallat e shfaqjeve, përcaktohet në bazë të numrit total të vendeve ulur dhe:

Për 301 deri në 1001 vende ulur, minimumi 2% e tyre duhet të jenë të përshtatura”,

Komisioneri vlerëson se salla e shfaqjeve të TKOBAP-së, aktualisht duhet të kishte 16 (gjashtëmbëdhjetë) vende të dedikuara për PAK.

Nisur nga fakti se godina e TKOBAP-së është rikonstruktuar së fundmi, dhe VKM-ja sipërcituar i ka shtrirë efektet ligjore që prej vitit 2008 e aktualisht, përcaktimet e saj lidhur me numrin e vendeve të dedikuara për PAK, në proporcion me numrin total të kapacitetit të vendeve ulur të Teatrit, duhet të ishin marrë në konsideratë paraprakisht nga ana e Institucionit.

Nëpërmjet shkresës me nr. 82/1 prot., datë 31.01.2022, Komisioneri ka informuar TKOBAP, se në rast se do të merreshin masa konkrete lidhur me realizimin e vendeve të dedikuara personave me AK, sipas specifikimeve të bëra në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, një fakt i tillë do të vlerësohej si hap pozitiv për efekt të shqyrtimit të kësaj çështjeje.

Pavarësisht sa më sipër, nga ana e TKOBAP nuk pati veprime konkrete në kuadër të marrjes në konsideratë të faktit të realizimit të 16 vendeve të dedikuara për PAK, në ambientet e Teatrit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se salla e shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, nuk përmbush të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë TKOBAP, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë.

Në rastin konkret, ka vënë në pozita të pafavorshme subjektin ankues, S. L, lidhur me episodin e datës 15.12.2021, kur ka ndjekur shfaqjen e vënë në skenë të operas “La Boheme”, por gjithashtu, Komisioneri, vëren se, edhe në të ardhmen mund të përsëritet e

njëta situatë, për të gjithë personat me AK që do të duan të ndjekin programet e shfaqjet e vëna në skenë nga Teatri, përse kohë nuk janë marrë masa për ndreqjen e situatës.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, përfshirë edhe të drejtën për një jetë sociale e kulturore, Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara, me qëllim sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendeve të dedikuara për PAK, në kuadër të aksesueshmërisë dhe eliminimit të barrierveve arkitektonike, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara (përfshirë edhe subjektin ankues si individ i veçantë) ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me pjesën tjetër të publikut.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹³, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

B/1 Aftësia e kufizuar

¹³ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, *së pari, si individ*, nga ana e TKOBAP, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke iu mohuar dy të drejta që duhej t’i njiheshin e siguroheshin nga ana e subjektit TKOBAP (*Teatri*), siç janë: përfitimi i biletës për të ndjekur shfaqjen me çmim të përgjysmuar, si dhe qëndrimi në vendet e dedikuara për PAK, në ambientet e sallës ku jepen shfaqjet e Teatrit, dhe *së dyti, në tagrin e përfaqësueses së Fondacionit “Së Bashku”*, ka pretenduar se diskriminohet e gjithë kategoria e PAK, me të njëjtën aftësi të kufizuar si ajo, përmes mohimit të aksesimit të vendeve të dedikuara për PAK.

Lidhur me sa më sipër, referuar akteve të depozituara nga subjekti ankues (*Fondacioni*), rezulton se, objekti dhe synimet parësore të Fondacionit “Së Bashku” janë:

- T’u përgjigjet nevojave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje nga shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj). Kjo do të realizohet nëpërmjet shërbimeve shëndetësore në komunitet, nxitjes së aktiviteteve sociale, riintegruese, nxitjes së biznesit social, teknologjisë si dhe avokatisë dhe lobimit në strukturat shtetërore qendrore dhe locale për përmirësimin e kushteve shëndetësore dhe sociale të grupeve të mësipërme.
- Të mbështesë aktivitetet lokale që kanë ndikim në zhvillimet sociale, duke përfshirë edukimin, kujdesin shëndetësor, fuqizimin, rrjetëzimin dhe integrimin e grupeve sociale të lëna mënjanë...
- Të ofrojë shërbimet e sipërpërmendura në nivel lokal, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organizatat kombëtare e ndërkombëtare që janë aktive në fushat e përbashkëta të ndërhyrjes...etj.

Lidhur me faktimin e aftësisë së kufizuar të shtetasës S. L, Komisioneri vlerëson se ajo e ka vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit mjeko-ligjor poshtëcituar:

- Vendim nr. 38, datë 13.02.2001, i KMCAP/Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka cilësuar se ankuesja vuan nga sëmundja “Tetraplegjia post fractura c₄-c₅”.
- Libreza “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. 00078, datë 19.02.2019, cilëson diagnozën e ankueses: “Tetraplegji”.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹⁴”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: “Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”.

¹⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e justifikon atë.

Subjekti ankues ka pretenduar se situata e krijuar sa i përket mungesës së aksesueshmërisë lidhur me vendet e dedikuara për PAK, në sallën e shfaqjeve të TKOBAP, përbën mohim të barazisë për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, duke sjellë si pasojë trajtim të pabarabartë të personave me aftësi të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të publikut në sallë. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diferencat në trajtim që bazohen në aftësinë e kufizuar, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, por dhe të gjithë personat e tjerë në kushte të njëjta a të ngjashme me të, përfaqësuar nga Fondacioni “Së Bashku”, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e TKOBAP, në raport me parashikimet ligjore të posaçme, lidhur me të drejtën për të aksesuar sallën e shfaqjeve të Teatrit, me vende të dedikuara për PAK.

Cështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, i saj shpreh se: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*”.

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta, ka parashikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në

pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁵.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...”.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

¹⁵Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁷. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por ka përparësi ndaj rendit tonë juridik.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (*Preambula e KDPAK, gërma “e”*). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit etj.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet,

¹⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

¹⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”* në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK)¹⁸, ka për qëllim të nxisë, mbrojtë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: *“Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar”* ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

- (a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- (b) Mosdiskriminimin;
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- (e) Mundësi të barabarta;
- (f) Akses;
- (g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- (h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

“1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.

2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.

3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshëm.

¹⁸ Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente”.

Në nenin 30, të Konventës, përcaktohet se:

“Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në jetën kulturore të vendit dhe do të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar:

- a) Gëzojnë akses në materialet kulturore në të gjitha formatet e aksesueshme;
- b) Gëzojnë akses në programet televizive, filmat, teatrot, dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të aksesueshme;
- c) Gëzojnë akses në institucionet apo shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët dhe për sa është e mundur gëzojnë akses në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare”.

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “Për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara” bazohet jo më në modelin e “bamirësisë”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuar, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Konkretisht, Konventa "Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", në nenin 4 ku parashikon “Detyrime të përgjithshme”, sanksionon shprehimisht se: “Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuar për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese”.

Në kontekst të interpretimit të bërë nga ana e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shtetet palë të kësaj konvente marrin përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me mosdiskriminimin dhe ruajtjen e barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Në interpretim të nenit 30, të kësaj Konvente, shtetet palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të gëzuar akses në institucionet apo shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat, etj.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara¹⁹”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Në kuptim të këtij Ligji:

- “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve;
- “Pengesat” nënkupton: ...ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjimit të pengesave të të gjitha llojeve;

Sa më lart, ku termi “aksesueshmëri” përcakton mënjanimin e pengesave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe pengesat institucionale, ato në legjislacion dhe në politikat e ndryshme hartuar në ndihmesë të personave me AK.

Neni 5, pika 1/2/ç) të këtij Ligji, përcaktojnë se:

“1. Jetesa e pavarur usiguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe ahsërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës, e ndër të tjera, të kenë aksesin përkatësisht:

ç) në qendrat kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike”.

¹⁹ Ligji ka për qëllim: “a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.

Në nenin 12, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50% të çmimit të biletës”.

VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, ka përcaktuar se: “Numri i nevojshëm i vendeve të përshtatura në sallat e shfaqjeve, përcaktohet në bazë të numrit total të vendeve ulur dhe:

Për 301 deri në 1001 vende ulur, minimumi 2% e tyre duhet të jenë të përshtatura”.

Detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, nuk duhet të ngarkojë personat me aftësi të kufizuara me shpenzimet e nevojshme për realizimin e përshtatjes. Gjithashtu, Komenti i Përgjithshëm nr. 6 (2018) vendos theksin tek fakti se barra e provës i takon subjektit që mbart detyrimin dhe që pretendon se barra e tij/saj do të ishte joproportionale ose e padrejtë.

“Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike²⁰”, ka në objekt të saj përcakimin e kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Fusha e aplikimit të saj shtrihet në: *“...të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit; ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes; ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik”.*

Neni 3, i kësaj VKM, ka përcaktuar se “barrierat arkitektonike” janë:

“1...a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;

2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë individët, me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

6. Mjet ndihmës për lëvizje - është karroca për PAK, shkopi, paterica dhe mjete të tjera ndihmëse për ecje;

²⁰ Miratuar me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008.

8. Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimore ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi”.

Në nenin 15, të Kreut II, të kësaj VKM, përcaktohet se:

“1. Rregullat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për të gjitha llojet e ndërtesave.
2. Në ndërtesat publike duhet garantuar një nivel i arritshmërisë në hapësirat e brendshme i tillë që të mundësojë shfrytëzimin e ndërtesës si nga publiku ashtu edhe nga personeli në shërbim, sipas rregullave të dhëna në nenin 4 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.
3. Për hapësirat e jashtme që ju përkasin ndërtesave, kushti i domosdoshëm i arritshmërisë quhet i plotësuar nëse ekziston të paktën një rrugë për hyrje në ndërtesë e shfrytëzueshme edhe nga ana e personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota dhe ndijues”.

Neni 1, i Pjesës II “Rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshëmrisë dhe fushëpamjes në ndërtesa”, ka përcaktuar se këto rregulla aplikohen në: “...ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo; ndërtesat rezidenciale publike të financuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja; ristrukturimet e ndërtesave private dhe publike; hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara”.

VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, në pikën 1, të Kreut I, të saj ka përcaktuar se:

“Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara”.

3. Janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

4. Ky vendim e shtrin zbatimin mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik”.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, evidentohet se janë shkelur të gjitha dispozitat ligjore që përcaktojnë të drejtën e PAK lidhur me aksesueshmërinë në sallën e TKOBAP, për vendet e dedikuara për PAK.

Në këtë kontekst, nga ana e Teatrit nuk janë marrë masa konkrete për zbatimin e dispozitave të mësipërme ligjore, gjë që është pohuar e pranuar prej tyre. Nga ana tjetër, pavarësisht se është pohuar se do të ndërmerren hapa për rregullimin e situatës në të ardhmen, nuk është provuar e dokumentuar konkretisht një fakt i tillë para Komisionerit.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të

përfiturar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Në bazë të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Referuar në nenin 6 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.²¹ Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga TKOBAP,

²¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

kundrejt shtetases S. L dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues, përfaqësuar nga Fondacioni, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se subjekti ankues dhe të gjithë personat e tjerë në kushte të njëjta a të ngjashme me të (*me aftësi të kufizuara me status tetraplegjiku*,) i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për të aksesuar vendet e dedikuara për PAK, në sallën e shfaqjeve të TKOBAP.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Teatrit, lidhur me shkakun e mbrojtur, në kuadër të veprimeve të ndërmarra.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës²², Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Teatrit, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se ajo vetë dhe të gjithë PAK me status para dhe tetraplegjiku, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e TKOBAP, përmes mosofrimit të vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të Teatrit, megjithëse legjislacioni, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Tetarit në këtë rast, për të përmbushur kërkesat ligjore në favor të kësaj kategorie personash.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues/PAK me status tetraplegjiku, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Teatrit, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata kishin shprehur vullnetin për të përmbushur detyrimin ligjor përse i takon rimbursimit të biletës së shfaqjes, si dhe për të ndihmuar në akomodimin e saj në ndjekjen e shfaqjes së datës 15.12.2021.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur dhe me dinjitet. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson vullnetin e shprehur nga ana e TKOBAP për të ndërmarrë hapa konkretë lidhur me mundësinë për sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendeve të dedikuara për PAK, proporcionalisht me numrin në total të vendeve të sallës së Teatrit, por, thekson se, mungesa e këtyre vendeve aktualisht, dhe deri në momentin e krijimit të tyre, konform parashikimeve ligjore sipërcituar, i vë ata në pozita të pabarabarta e të pafavorshme me të tjerët që nuk posedojnë shkakun e mbrojtur, duke çenuar dinjitetin e tyre, përmes sistemimit të tyre në vende të tjera, që nuk janë të dedikuara për ta, duke bërë që ata të ndjehen të diferencuar e të ekspozuar në vendet e përshtatura (siç është përshtatja e hapësirave në rreshtin me korridorin më të gjerë/ rreshti I i protokollit G, cituar në përgjigjen e TKOBAP drejtuar Komisionerit).

²² Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve (PAK) duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025²³, citon ndër të tjera se:

“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, subjekti ankues, dhe gjithë personat e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme më të, mund të jenë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nëpërmjet mosmarrjes së masave për

²³ VKM nr. 276, datë 12.05.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025”.

zgjdhjen e problematikës së vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të TKOBAP, megjithëse ankuesja posedonte shkakun e mbrojtur nga ligji, atë të aftësisë së kufizuar dhe Teatri ishte në dijeni të plotë të këtij fakti.

Në këto kushte TKOBAP, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nga ana e Teatrit, është pranuar se salla nuk ka vende të dedikuara për PAK, konform parashikimeve të akteve ligjore e nënligjore. Përgjigjja e Teatrit, se në të ardhmen mund të vendosë të heqë disa karrige për për të mundësuar akomodimin e PAK, pa asnjë provë konkrete dhe asnjë afat se kur do të ndreqet situata apo se ka iniciuar një procedurë të tillë, nuk justifikon faktin e mosmarrjes së masave efektive prej tyre për aksesueshmërinë e PAK në vendet e dedikuara për ta. Përgjigjja e TKOBAP dhe mosveprimi i tyre për rregullimin e situatës lidhur me vendet e dedikuara për PAK, nuk ka një justifikim të arsyeshëm e objektiv përse i takon zbatimit të pikës 15, të VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”* dhe masave që duhet të ndërmerren për përmbushjen e saj. Teatri nuk ka sjellë asnjë fakt apo provë që të justifikojë se mosveprimi i tyre ka ndonjë justifikim të arsyeshëm e objektiv, se përse nuk ishte mundësuar realizimi i i 16 vendeve të dedikuara për PAK, në kushtet kur i gjithë institucioni i TKOBAP i ishte nënshtruar së fundmi një rikonstruksioni të përgjthshëm të tij; apo të jetë i bazuar në ndonjë studim i cili të kishte reflektuar dhe kostot e mundshme që mund të kërkonte kjo ndërhyrje.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se TKOBAP, me mosveprimin e tij, ka diskriminuar subjektin ankues, dhe të gjithë PAK, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për aksesim në vendet e dedikuara për PAK.

Për rrjedhojë TKOBAP, ka shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, bazuar në analizën e fakteve, provave, legjislacionit dhe bindjes së krijuar, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e TKOBAP, dhe kjo mund të realizohet nëpërmjet ofrimit nga ana e TKOBAP, të (16) vendeve të dedikuara për PAK, në ambientet/sallën e shfaqjeve të Teatrit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 6, nenin 7, nenin 20 pika 1, shkronja a) dhe pika 4, e tij, nenin 32, shkronja a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasve S. L dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga ana e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor (TKOBAP), për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e TKOBAP, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë për vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, TKOBAP, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Rekomandohet që TKOBAP, në kuadër të marrjes së masave pozitive për PAK, të marrë masa konkrete për reduktim të çmimit të biletës, për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Aftësia e kufizuar
Lloji i vendimit: Diskriminim